VENDIM
Nr. 75/2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 32/2016 "PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË HETUAR DHE VERIFIKUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI DHE MBROJTJEN E INTERESIT TË SHTETIT SHQIPTAR GJATË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE NEGOCIMI I MARRËVESHJES SË SHITJES SË AKSIONEVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10 116, DATË 23.4.2009, "PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR QIND TË AKSIONEVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE CEZ AS", SI EDHE EVIDENTIMI I EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË SHKAKTUARA NGA NDJEKJA E ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE", NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 30/2016

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit të Kuvendit nr. 32/2016 "Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për të hetuar dhe verifikuar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negocimi i Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, "Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.", si edhe evidentimi i efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje", ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2016", bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Arben Ristani caktohet zëvendës-kryetar.

II. Deputetja Dhurata Çupi caktohet anëtare në vend të zotit Sherefedin Shehu.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 3.11.2016